



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM FIER

NJOFTIM PËR SHTYP

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, e përbërë në trup gjykues prej:

GJYQTAR : NOEL VEIZI

në Fier, sot më datë **12.07.2026**, mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore me dyer të mbyllura, çështjen penale me që iu përket palëve:

- Kërkues:** **Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier; Përfaqësuar nga Prokurorja e çështjes Znj. Violeta Shkurta.**
- Person nën hetim:** **L.L, Mbrojtur në gjykim nga mbrojtësja e zgjedhur me deklaram në seancë Av. Arvenola Dore, anëtare e Dhomës Vendore të Avokatisë Fier.**
- Akuza:** Kryerja e veprës penale të “*Heqja e paligjshme e lirisë*” në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 110/2, i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.
- E mitura në konflikt me ligjin:** **K.G, Asistuar nga përfaqësuesja ligjore Znj.E.G (nëna) dhe psikologia Znj.Daniela Gjorgo. Mbrojtur në gjykim nga mbrojtësi i zgjedhur me deklaram në seancë Av. Ronaldo Prifti, anëtar i Dhomës Vendore të Avokatisë Fier.**
- Akuza:** Kryerja e veprës penale të “*Heqja e paligjshme e lirisë*” në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 110/2, i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.
- E mitura në konflikt me ligjin:** **M.R, E pranishme në gjykim përfaqësuesja ligjore Znj. R.R (nëna) dhe asistuar nga punonjësja sociale e Njesisë së Shërbimit Social për të mitur pranë Bashkisë Fier, znj. Alma Guma, e caktuar nga gjykata si kujdestar i posaçëm, si dhe psikologia Znj. Daniela Gjorgo. Mbrojtur në gjykim nga mbrojtësi i caktuar kryesisht Av. Urana Fejzulla, anëtare e Dhomës Vendore të Avokatisë Fier.**
- Akuza:** Kryerja e veprës penale të “*Heqja e paligjshme e lirisë*” në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 110/2, i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.
- Objekti:** Verifikimi i kushteve dhe kriterëve për zbatimin e masave të sigurimit personal në lidhje me procedimin penal Nr. 1094/2026, në lidhje me veprën penale “*Heqja*”

e paligjshme e lirisë” në bashkëpunim, të parashikuar nga 110/2 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Baza Ligjore:

Nenet 228-230, 237, 238, 239, dhe 248 të Kodit të Procedurës Penale dhe Nenet 81 e 86 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Gjykata, në përfundim gjykimit të zhvilluar në prani të Prokurores, në prani të personit nën hetim **L. L**, si dhe në prani të mbrojtësit ligjor të zgjedhur, **Av.Arvenola Dore**, në prani të të miturës në konflikt me ligjin **K.G**, në prani të përfaqësueses ligjore, **Znj. E.G** (nëna), në prani të mbrojtësit të zgjedhur **Av. Ronaldo Prifti**, dhe në prani të të miturës në konflikt me ligjin **M.R**, në prani të përfaqësueses ligjore, **Znj. R. R** (nëna), asistuar dhe nga punonjësja sociale pranë Njesisë së Shërbimit Social për të mitur pranë Bashkisë Fier **znj. Alma Guma**, e caktuar nga gjykata si kujdestar i posaçëm, në prani të mbrojtësit të caktuar kryesisht **Av.Urana Fejzulla**, në prani të psikologes **Znj. Daniela Gjorgo** dhe në prani të Njesisë së Shërbimit Social për të mitur pranë Bashkisë Fier, pasi shqyrtoi në tërësi rrethanat e çështjes, mori, administroi dhe vlerësoi provat e marra në seancë gjyqësore, në bazë dhe për zbatim të nenit 112, 237, 238, 239, dhe 248 të Kodit të Procedurës Penale:

VENDOSI:

1. Vijimin e zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “*Arrest në burg*”, parashikur nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, të caktuar ndaj personit nën hetim **L.L**, nëpërmjet vendimit **nr. 62-2026-4539 (1082), datë 09.07.2026**, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
2. Vijimin e zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “*Arrest në shtëpi*”, të parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, të caktuar ndaj të miturës në konflikt me ligjin **K.G**, nëpërmjet vendimit **nr. 62-2026-4539 (1082), datë 09.07.2026**, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
3. Vijimin e zbatimit të masës së sigurimit personal, “*Shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik*”, të parashikuar nga neni 239 i K.Pr.Penale, pranë një Institucioni të Posaçëm për të Mitur, pranë Qendrës Spitalore të Burgjeve, të caktuar ndaj të miturës në konflikt me ligjin **M.R**, nëpërmjet vendimit **nr. 62-2026-4539 (1082), datë 09.07.2026**, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
4. Ngarkohet Prokuroria e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier në bashkëpunim me Policinë Gjyqësore për ekzekutimin e këtij vendimi.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, brenda 5 (pesë) ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të vendimit të arsyetuar të gjykatës.

U shpall në Fier, sot, më datë 12.07.2026.

**GJYQTAR
NOEL VEIZI**